

DOKUMENT ME REKOMANDIME PËR POLITIKAT PUBLIKE

ANALIZË E KORNIZËS LIGJORE PËR MBIKËQYRJEN INSPEKTUESE LOKALE

Qershor 2026

Prof. dr. Natasha Gaber Damjanovska

Doc. dr. Millka Dimitovska

Ass. mr. Tijana Angova Haxhieva

Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit „**Inspektorët lokalë nën tjerëz: Përmirësimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë së inspektimit lokal**“, i cili zbatohet nga Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup (IDSCS), në partneritet me Institutin për Hulumtime Sociologjike, Politike dhe Juridike (ISPPI) pranë Universitetit „Shën Kirili dhe Metodi“ – Shkup, me mbështetjen e Qeverisë së Zvicrës përmes Civica mobilitas.”

„Civica mobilitas“ është projekt i Qeverisë së Zvicrës, i cili zbatohet nga MCMS, NIRAS dhe FCG. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës, „Civica mobilitas“ apo të organizatave që e zbatojnë.

IMPRESUM

Titulli:

Analizë e kornizës ligjore për mbikëqyrjen inspektuese lokale

Botues:

Instituti për Demokraci „Societas Civilis“ – Shkup

Autorë:

Prof. dr. Natasha Gaber-Damjanovska,

Doc. dr. Millka Dimitrovska,

As. mr. Tijana Angova-Haxhieva

Dizajn:

Katarina Prenda

Vendi dhe viti i botimit:

Shkup, qershor 2026

DOKUMENT ME REKOMANDIME PËR POLITIKAT PUBLIKE

ANALIZË E KORNIZËS LIGJORE PËR MBIKËQYRJEN INSPEKTUESE LOKALE

PËRMBAJTJA

Gjetjet	6
01 · Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	6
02 · Ligji për vetëqeverisjen lokale (2002)	6
03 · Ligji për bashkëpunim ndërkomunal (2009)	8
04 · Ligji për mbikëqyrje inspektuese (2025).....	8
05 · Ligji për procedurë të përgjithshme administrative (2015)	14
06 · Kompetencat e inspektorëve lokalë.....	14
07 · Kryerja e mbikëqyrjes inspektuese	17
08 · Mbikëqyrje mbi ligjshmërinë gjatë punës së shërbimeve inspektuese lokale.....	19
Konkluzione dhe rekomandime	22
REFERENCA	25
SHTOJCA: Lista e ligjeve që përmbajnë dispozita të drejtpërdrejta për mbikëqyrje inspektuese lokale	27

RRETH KËTIJ DOKUMENTI



Ky dokument ka për qëllim që, në mënyrë koncize, të paraqesë rezultatet e analizës së gjerë juridike të ligjeve materiale relevante për inspektorët lokalë, me fokus në mundësitë normative, pengesat dhe hapësirat për përmirësim normativ të ligjshmërisë dhe përgjegjësisë në funksionimin e inspektimeve lokale.

Në analizë nuk janë përfshirë kundërvajtjet dhe përputhshmëria e dispozitave kundërvajtëse të ligjeve sektoriale me Ligjin për kundërvajtje, prandaj nga pasqyra janë përjashtuar dispozitat procedurale, por edhe dispozitat ndëshkuese, si dhe çështja e financimit të veprimtarisë inspektuese.

Për më tepër, analiza nuk përfshin as zbatimin në praktikë të dispozitave materiale.

GJETJET



01

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Ndryshimet kushtetuese të vitit 2001 mundësuan realizimin e një shkalle më të lartë të decentralizimit të pushtetit, përkatësisht krijuan mundësi që njësitë e vetëqeverisjes lokale të kenë autonomi më të madhe në realizimin e kompetencave të tyre, por edhe në mbikëqyrjen e tyre, në rastet kur Republika ua ka besuar këtë me ligj. Për këtë qëllim, në kuadër të shërbimeve publike të njësive të vetëqeverisjes lokale (në vijim: NJVL), është mundësuar që ato në mënyrë të pavarur të theme-lojnë inspekcione përkatëse.

02

LIGJI PËR VETËQEVERISJE LOKALE (2002)



Sipas Ligjit për vetëqeverisjen lokale të vitit 2002, si lex specialis, NJVL-të mund të veprojnë *në të gjitha fushat, të përcaktuara shprehimisht në ligj ose edhe në ato që nuk janë të përcaktuara në mënyrë eksplicite, me përjashtim të fushave që qartësisht janë në kompetencë të organeve të pushtetit qendror*.¹ Kompetencat konkrete të NJVL-ve, si rregull, janë të plota dhe ekskluzive, ushtrohen përmes rregullimit dhe kryerjes së ligjshme, të pavarur dhe të përgjegjshme të çështjeve *me interes publik me rëndësi lokale*,² të përcaktuara me këtë ligj ose me ligje të tjera, si dhe përfshijnë edhe kryerjen e *mbikëqyrjes*³ mbi këta. Kompetencat nuk mund të merren ose të kufizohen, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

¹ Neni 20, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

² Neni 21, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

³ Neni 22, paragrafi 11, alinea 12, Ligji për vetëqeverisjen lokale „Gazeta Zyrtare e RVM-së“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

*Standardet dhe procedurat sipas të cilave NJVL-të udhëhiqen gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, si dhe kompetencat që NJVL-të janë të detyruara t'i ushtrojnë, përcaktohen me ligj.*⁴

Ligji mundëson gjithashtu realizimin e kompetencave të deleguara nga shteti te NJVL-të, por me detyrim për respektimin e *standardeve të përcaktuara me ligj dhe përmes respektimit të parimit të përgjegjësisë subsidiarë*.⁵ Kur bëhet fjalë për mbikëqyrjen mbi organet e NJVL-ve për kryerjen e punëve të deleguara që janë në kompetencë të organeve të administratës shtetërore, atëherë ushtrohet mbikëqyrja e ligjshmërisë dhe mbikëqyrja e efikasitetit.

Sipas Ligjit, Këshilli i NJVL-së mund të themelojë shërbime publike ose, në alternativë, t'ua delegojë kryerjen e punëve të caktuara me interes publik me rëndësi lokale personave të tjerë juridikë ose fizikë.⁶ Në të dyja rastet, NJVL-ja mban përgjegjësi subsidiarë për realizimin e këtyre punëve me interes publik dhe ushtron mbikëqyrje mbi to.

NJVL-të *mund të organizojnë inspektorat komunal* me qëllim të kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese mbi ushtrimin e punëve që janë në kompetencë të tyre.⁷ Me këtë bëhet *dallim i qartë* ndërmjet inspektoratit shtetëror dhe atij komunal, duke e lidhur kompetencën mbikëqyrëse të NJVL-së me kompetencat konkrete që ato i ushtrojnë në territorin e tyre, në fushat e përcaktuara në listën e kompetencave të parashikuara me Ligj. Këshilli i NJVL-së ka mundësi të monitorojë, kontrollojë dhe vlerësojë punën e inspektorateve që i ka themeluar vetë.⁸

Për një themelim dhe funksionim më efikas dhe më efektiv të shërbimeve inspektuese të NJVL-ve, Ligji parashikon mundësinë e bashkëpunimit ndërkomunal, me qëllim të realizimit të interesave të përbashkëta dhe kryerjes së punëve të përbashkëta që janë në kompetencë të tyre.⁹

⁴ Neni 22, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

⁵ Neni 24, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

⁶ Neni 24, neni 36 dhe neni 2, paragrafi 1, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

⁷ Neni 57, paragrafi 2, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

⁸ Neni 57, paragrafi 4, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

⁹ Neni 14, Ligji për vetëqeverisje lokale, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 5/02 dhe 202/2024.

03



LIGJI PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL (2009)

Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal (2009) në mënyrë më të detajuar e operacionalizon kornizën normative përmes së cilës komunat kanë mundësi t'i bashkojnë dhe t'i integrojnë kapacitetet kadrovike, operative dhe financiare për formimin e organeve të përbashkëta administrative më efikase, ndër të cilat edhe inspektorateve lokale, me qëllim të arritjes së standardizimit, sigurimit të ligjshmërisë në punë dhe mbrojtjes së interesit publik lokal të qytetarëve në fushat e kompetencave të NJVL-së. Kjo shërben gjithashtu për tejkalimin e problem-it të vazhdueshëm të mungesës së kuadrove, mjeteve financiare dhe burimeve të tjera me të cilat përballen një numër i madh komunash.

Është e nevojshme të theksohet shkalla e kompleksitetit të çështjes së formimit të shërbimeve inspektuese si rezultat i bashkëpunimit ndërkomunal. Këshillat e komunave, me shumicë të thjeshtë, miratojnë vendimin për themelimin e shërbimeve të përbashkëta ose formave të tjera të bashkëpunimit ndërkomunal.¹⁰, ndërsa për monitorimin e gjendjes secili kryetar komune është përgjegjës për territorin e tij.¹¹ Në Ligjin për bashkëpunimin ndërkomunal janë përcaktuar në mënyrë taksative elementet e marrëveshjes për bashkëpunim, duke paraparë edhe përgjegjësi materiale, proporcionale me vëllimin e punës së kryer në emër dhe për llogari të secilës komunë që ka themeluar këtë formë bashkëpunimi. Megjithatë, rëndësi e veçantë kanë parimet e rrjetit të përgjegjësisë së inspektorëve në sistemin e administratës publike, përmes zbatimit të parimeve të hierarkisë dhe subordinimit.

04



LIGJI PËR MBIKËQYRJE TË INSPEKTORATIT (2025)

Në përgjithësi, funksionimi i shërbimeve lokale të inspektoratit është i rregulluar me Ligjin për mbikëqyrje të inspektoratit (2025) (në tekstin metejshëm: LMI), por edhe me të gjitha ligjet materiale sektoriale që rregullojnë çështjet nga kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale. Në këtë mënyrë është rregulluar edhe funksionimi i shërbimeve të

¹⁰ Neni 4, Ligji për bashkëpunim ndërkomunal, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 79/09 dhe 241/24.

¹¹ Neni 17, Ligji për bashkëpunim ndërkomunal, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 79/09 dhe 241/24.

veçanta të inspektoratit.

Me këtë, materia që ka të bëjë me inspektimet lokale është e rregulluar në të gjitha aspektet funksionale: përmes përcaktimit të themelimit, statusit, përzgjedhjes dhe përgjegjësisë së inspektorëve, përcaktimit të fushëveprimit, përkatësisht të kompetencave të tyre, financimit të veprimtarisë së tyre, mënyrës së veprimit, më saktësisht ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, si dhe formave të mbikëqyrjes dhe formave të mundshme të bashkëpunimit, me qëllim sigurimin e plotësisë në konstatimin e gjendjes faktike dhe në përcaktimin e përgjegjësisë së subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes. Sistemi është kryesisht i decentralizuar, në përputhje me modelin e vetëqeverisjes lokale njëshkallëshe, por me një hierarki dhe përgjegjësi të përcaktuar brenda sistemit të administratës publike, ku pushteti qendror ushtron kontroll dhe shërben si mekanizëm korigjues për garantimin e ligjshmërisë dhe efektivitetit të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të shërbimeve lokale të inspektimit.

THEMELIMI, ZGJEDHJA DHE PËRGJEGJËSIA E INSPEKTORËVE



Sipas Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit (2025), thelbi i mbikëqyrjes inspektuese qëndron në *mbikëqyrjen e zbatimit dhe të aplikimit të ligjeve dhe të rregulloreve të tjera nga ana e organeve shtetërore, ndërmarrjeve publike, shoqërive tregtare, institucioneve, si dhe personave fizikë dhe juridikë*.¹² Në vendin tonë, inspektimet janë të organizuara në **dy nivele** edhe atë a) si *inspektorate shtetërore për fusha të caktuara*, të themeluara si organe në kuadër të ministrive, dhe b) si **shërbime inspektuese** të organizuara si njësi organizative për ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese në *organet e administratës shtetërore, në komnatat, komnatat e Qytetit të Shkupit* dhe në Qytetin e Shkupit, në formën e sektorëve ose departamenteve për mbikëqyrje inspektuese.¹³ Madje, siç u përmend edhe më lart, në përputhje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale, parashihet mundësia, por jo detyrimi, për organizimin e një shërbimi komunal të inspektimit për ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese mbi kryerjen e punëve që janë në kompetencë të NJVL.

Parimi i funksionimit të shërbimeve inspektuese është identik, pa dallime në përbërjen e cila parashihet sipas ligjit. *Dallimi thelbësor ndërm-*

¹² Neni 3, paragrafi 1, pika 2, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

¹³ Neni 17, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

jet këtyre dy grupeve qëndron në mbikëqyrjen e kompetencave të rregulluara me ligjet e veçanta materiale në fusha të ndryshme dhe territorin që e mbulojnë.

Dy nivele të organizimit të inspeksioneve

Inspektoratet shtetërore për fusha të veçanta

të themeluara si organe në përbërje të ministrive.

Shërbimet inspektuese

të organizuara si njësi organizative për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në organet e administratës shtetërore, në komunat, në komunat e Qytetit të Shkupit dhe në Qytetin e Shkupit.

Shërbimet inspektuese drejtohen nga personat e organit të administratës shtetërore ose nga kryetari i NJVL, në kuadër të së cilës është organizuar shërbimi inspektues.¹⁴ Kompetencat e funksionarit/kryetarit i cili është person udhëheqës i shërbimit inspektues, janë në masë të madhe të ngjashme me kompetencat e drejtorit të inspektoratit shtetëror. Nga kjo mund të konstatohet se *hierarkia dhe përgjegjësia e shërbimeve lokale të inspektimit janë të përcaktuara qartë, duke qenë se ato i përgjigjen kryetarit të komunës, përkatësisht kryetarit të Qytetit të Shkupit*, i cili i udhëheq shërbimet inspektuese. Këshilli i NJVL themelon shërbimet publike në kuadër të njësisë dhe ushtron mbikëqyrje mbi punën e tyre.

STATUSI I INSPEKTORATEVE DHE KUALIFIKIMET E NEVOJSHME



Sa i përket statusit, sipas Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese (2025), inspektorët kanë statusin e nëpunësve administrativë¹⁵, përkatësisht **të nëpunësve të veçantë shtetërorë**¹⁶, sipas Ligjit për nëpunësit administrativë (2025), i cili lë mundësi që me ligje të veçanta të përcaktohen kushte të posaçme për plotësimin e vendeve të punës për nëpunësit e veçantë shtetërorë me ligje të veçanta.¹⁷ Ky dallim terminologjik në legjislacion duhet të jetë çështje që duhet të harmonizohet, pasi krijon pasiguri juridike.

¹⁴ Neni 19, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

¹⁵ Neni 3, paragrafi 1, pika 1, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

¹⁶ Neni 6, Ligji për nëpunësit administrativ, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 144/25.

¹⁷ Neni 23, Ligji për nëpunësit administrativ, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 144/25.

Kategoritë e inspektorëve janë të rregulluara me ligj, sipas kriterëve të përcaktuara. Inspektorët i nënshtrohen edhe provimit profesional,^{18/19} ndërsa gjatë ushtrimit profesional të funksionit²⁰ të tyre janë të detyruar të respektojnë dispozita të përgjithshme dhe të veçanta (për shembull, në lidhje me autorizimin identifikues dhe simbolin zyrtar). Megjithatë, provimi profesional e japin të bazuar kryesisht në procedura (procedurën e përgjithshme administrative dhe kontestin administrativ, procedurën inspektuese dhe atë kundërvajtëse)²¹, ndërsa nuk janë të përcaktuara qartë kriteret që do të garantonin se një inspektor duhet të ketë njohuri profesionale nga fusha përkatëse për të cilën kryen mbikëqyrjen (për shembull, që inspektor për çështjet e ndërtimtarisë të mund të jetë vetëm person me arsimim profesional si inxhinier i ndërtimtarisë). Gjithashtu, përveç ekspertizës themelore profesionale, është e nevojshme edhe zotërimi i një korpusi të caktuar të njohurive juridike nga fusha përkatëse, prandaj shtrohet pyetja e hapur – a ekziston një mekanizëm i institucionalizuar për bartjen e njohurive dhe ruajtjen e kujtesës institucionale? Duke pasur parasysh se do të ishte praktikisht e pamundur të kërkohej kualifikime profesionale maksimaliste, megjithatë duhet të këmbëngulet në organizimin e trajnimeve të standardizuara për ligjet sektoriale dhe aktet nënligjore, si detyrim formal i komunës. Për këtë çështje, në fakt, ekziston një mekanizëm i përcaktu-

Provimin profesional e japin në bazë të procedurave (procedurës së përgjithshme administrative dhe kontestit administrativ, procedurës inspektuese dhe kundërvajtëse), por nuk janë të përcaktuara qartë kriteret sipas të cilave inspektor mund të bëhet një person që ka njohuri nga fusha në të cilën kryen mbikëqyrjen.

^{18,19} Neni 31, 36, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25, Ministria e Administratës Publike, Njoftim 09.03.2026, <https://mja.gov.mk/mk-MK/odnosi-so-javnost/najavi/skratena-programa-za-polaganje-na-ispitot-za-inspektor>. Përkatësisht, kandidatët për inspektorë të cilët procedurën për fitimin e statusit të inspektorit e kanë filluar para ditës së fillimit të zbatimit të Ligjit të ri për mbikëqyrje të inspektoratit („GZRMV“, nr. 135/2025 dhe 269/2025), ndërsa sipas Ligjit për mbikëqyrjen inspektuese („GZRMV“, nr. 102/19, 272/24 dhe 22/2025), në periudhën aktuale do ta japin provimin sipas Programit të shkurtuar të Ministrisë së Administratës Publike. Ndërsa, për inspektorët të cilët në të ardhmen do ta japin provimin sipas Ligjit të ri për mbikëqyrje të inspektoratit (2025), ky provim do të organizohet nga Akademia për përsosje profesionale dhe trajnim të nëpunësve administrativë (Ligji për përsosje profesionale dhe trajnim të nëpunësve administrativë, „GZRMV“, nr. 144/25), e cila duhet të themelohet brenda afatit prej 15 ditësh nga fillimi i zbatimit të Ligjit për përsosje profesionale dhe trajnim të nëpunësve administrativë (2025), përkatësisht në janar të vitit 2027.

²⁰ Neni 32-34 dhe 37, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²¹ Neni 36, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

ar – njësia administrative kujdeset për nevojat kadrovike dhe mund t'i propozojë Këshillit të komunës zgjidhje përkatëse juridike.

Gjithashtu, me Ligjin e mëparshëm për mbikëqyrje të inspektoratit (2010) rregulloheshin kushtet dhe mënyra e lëshimit dhe heqjes së licencës për inspektor. Me ligjin e ri të vitit 2025, licencimi i inspektorëve është hequr, ndërsa inspektorët pajisen vetëm me vërtetime për dhënien e provimit për inspektor.²² Në mënyrën se si janë rregulluar aktualisht, këto vërtetime nuk do të mund të pasqyrojnë shkallët e ndryshme të kompleksitetit të detyrave të punës që kryejnë inspektorët.

KOLEGIUMI I DREJTORËVE TË INSPEKTORATEVE SHETËRORRE



Me Ligjin e ri për mbikëqyrje të inspektoratit (2025) tejkalohen një pjesë e madhe e problemeve të mëparshme lidhur me harmonizimin e ligjeve materiale në aspektin e mbikëqyrjes inspektuese, veçanërisht në pjesën që ka të bëjë me procedurën e veprimit dhe përgjegjësinë e inspektorëve. Njëkohësisht, me këtë ligj themelohet edhe **Kolegiumi i drejtorëve të inspektorateve shtetërore**, i cili paraqet një organ koordinues pune ndër resor, përmes të cilit krijohet mundësia për harmonizimin e mangësive në komunikimin operativ, ndërinstitutional dhe ndërmjet shërbimeve inspektuese. Gjatë punës së këtij organi, ekziston mundësia që të ftohen dhe të marrin pjesë aktivisht *udhëheqësit ose inspektorët nga shërbimet inspektuese në kuadër të organeve të administratës shtetërore dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale*.²³ **Ky aspekt i bashkëpunimit nuk është konkretisht i operacionalizuar përmes normave juridike**, megjithëse parimet themelore të funksionimit të inspektimeve vlejnë për të dyja nivelet e organizimit të këtyre shërbimeve.

Kolegiumi i pranon për informim planet vjetore dhe raportet e punës së inspektorateve, pas së cilës e informon Qeverinë për punën e realizuar gjatë vitit paraprak, si dhe për *përcaktimet strategjike dhe prioritetet që dalin nga planet vjetore të inspektorateve*.²⁴ Gjithashtu, Kolegiumi përgatit *gjetje, udhëzime dhe rekomandime për përmirësimin e punës*

²² Neni 31, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.


²³ Neni 16, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²⁴ Neni 26-28, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²⁵ Neni 28, paragrafi 5, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

së inspektorateve.²⁵ Ky organ luan një rol të rëndësishëm në rastet kur paraqitet nevoja për kryerjen e mbikëqyrjes së përbashkët inspektuese nga dy ose më shumë inspektorate.²⁶ Në mënyrë të ngjashme, në rast nevojë dhe duke zbatuar të njëjtat hapa të përcaktuara me ligj, realizohet edhe mbikëqyrja e jashtëzakonshme inspektuese.²⁷

Si funksionon Kolegiumi?



Ligji parashikon se, varësisht nga vëllimi ose kompleksiteti i çështjes, mbikëqyrjen inspektuese mund ta kryejnë më shumë inspektorë nga e njëjta ose nga inspektorate të ndryshme.²⁸ Megjithatë, me një normë imperative përcaktohet se, në rastin kur gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori konstaton shkelje të ligjit, të ndonjë dispozite tjetër ose të ndonjë akti që është në kompetencë të një inspektorati tjetër, ai vetë e konstaton gjendjen faktike dhe për konstatimet përgatit raport, të cilin ia dorëzon inspektoratit kompetent.²⁹ Gjithashtu, mbikëqyrja inspektuese mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese.³⁰

As inspektoratet shtetërore dhe as inspektoratet lokale nuk kanë statusin e personave juridikë, megjithëse mund të kenë një shkallë të caktuar të autonomisë financiare, përkatësisht të disponimit me buxhetin e miratuar paraprakisht nga organi kompetent. Për shembull, inspektoratet shtetërore disponojnë në mënyrë të pavarur me buxhetin e miratuar nga ministria³¹, ndërsa inspektorët lokalë janë pjesë e shërbimeve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe për këtë arsye varen plotësisht nga ndarjet e përgjithshme buxhetore të komunës.

²⁶ Neni 60, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²⁷ Neni 63, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²⁸ Neni 50, paragrafi 3, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

²⁹ Neni 52, paragrafi 5, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

³⁰ Neni 56, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

³¹ Neni 17, paragrafi 3, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

05

LIGJI PËR PROCEDURË TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE (2015)



Gjithashtu, veprimtaria e inspektorëve lokalë rregullohet edhe me ligje procedurale, ndër të cilat më i rëndësishmi është Ligji për procedurë të përgjithshme administrative (si rregullativ subsidiare), megjithatë çështjet procedurale nuk kanë qenë objekt i kësaj analize. Në këtë ligj përcaktohen mundësitë për t'iu drejtuar organit kompetent për mbikëqyrje inspektuese, veçanërisht në rastet kur kërkohet ndihmë juridike dhe kur bëhet fjalë për shërbime me interes publik. Gjithashtu, Ligji përcakton se, kur bëhet fjalë për shërbime me interes të përgjithshëm (publik), për të cilat përdoruesi, edhe pse i ka përmbushur detyrimet e tij, konsideron se nuk merr shërbim me cilësi të përshtatshme, në mënyrë të vazhdueshme, transparente dhe pa diskriminim, mund të paraqesë *ankesë pranë organit publik mbikëqyrës* të përcaktuar me ligj, për aq kohë sa zgjat veprimi ose mosveprimi i caktuar nga ofruesi i shërbimit.³²

Sigurisht, LPPA-ja garanton parimin e mbrojtjes juridike në nenin 14, përkatësisht palëve u garantohet mbrojtja juridike kundër çdo veprimi administrativ ose çdo akti real. Në këtë mënyrë garantohet parimi i shkallës së dytë në procedurën administrative në fushën e mbikëqyrjes inspektuese, kryesisht përmes mundësisë së paraqitjes së ankesës kundër aktit inspektues pranë Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative, Procedurën e Marrëdhënieve të Punës dhe Mbikëqyrjen Inspektuese në Shkallë të Dytë.

06

KOMPETENCAT E INSPEKTORËVE LOKAL



Lidhur me mënyrën e veprimit, shërbimet lokale të inspektimit janë të kufizuara me ligj nga kompetenca lëndore dhe territoriale e komunës

Në përgjithësi, ndarja e kompetencave ndërmjet inspektorëve në nivel qendror dhe atij lokal është *përcaktuar qartë*, duke u mbështetur në dallimin ndërmjet dispozitave ligjore që përcaktojnë kompetencat e

³² Neni 103, paragrafi 3, Ligji për procedurë të përgjithshme administrative „Gazeta zyrtare e RM“, nr. 124/15 dhe 65/18.

organeve të pushtetit qendror dhe subjekteve administrative, nga njëra anë, dhe njësive të vetëqeverisjes lokale, nga ana tjetër. Në fakt, shërbimet lokale të inspektimit ushtrojnë kompetencat e tyre brenda fus-hëveprimit të kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale, të cilat janë përcaktuar në mënyrë të qartë dhe taksative në nenin 22 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe në nenin 10 të Ligjit për Qytetin e Shkupit, si dhe burojnë nga dispozitat kushtetuese që garantojnë vetëqeverisjen lokale. Më tej, në dispozitat ligjore në mënyrë të përsëritur haset formulimi që shpreh këtë kufizim të kompetencave: „në kuadër të kompetencave të tyre, komunat...”

Në disa ligje sektoriale, ndarja e kompetencave është bërë sipas kategorizimeve të caktuara (llojet e objekteve ndërtimore, toka, llojet e lejeve). Për shembull, inspektori shtetëror i ndërtimit kryen mbikëqyrje inspektuese mbi objektet ndërtimore të kategorisë së parë, përkatësisht ato që kanë rëndësi të veçantë për Republikën, ndërsa inspektori i autorizuar i ndërtimit kryen mbikëqyrje inspektuese mbi objektet ndërtimore të kategorisë së dytë³³, përkatësisht ato që kanë rëndësi lokale, të cilat janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar dhe taksative në nenin 57 të Ligjit për ndërtim. Shembull tjetër është kompetenca lidhur me monitorimin e trupave ujorë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, për të cilët është krijuar rrjeti shtetëror hidrologjik nën kompetencën e pushtetit qendror, si dhe rrjeti lokal hidrologjik, nën kompetencën e komunave dhe të Qytetit të Shkupit.³⁴ Më tej, si në Ligjin për veprimtarinë hotelierike, ashtu edhe në Ligjin për veprimtarinë turistike, kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese është përcaktuar sipas regjistrimit në të cilin është regjistruar subjekti.^{35/36} Kështu, si kriter fillestar për ndarjen e kompetencës merret fakti nëse ushtruesi i veprimtarisë është i regjistruar në regjistrin që mbahet nga kryetari i komunës, përkatësisht nga Qyteti i Shkupit, dhe në këtë rast mbikëqyrjen e kryejnë inspektorët e autorizuar të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

Në shumicën e ligjeve sektoriale, nga ana tjetër, nomoteknika dhe terminologjia e lidhur me mbikëqyrjen inspektuese janë të ngjashme. Në mënyrë të zakonshme, mbikëqyrja inspektuese rregullohet në një kapitull të veçantë, ku përcaktohen subjektet që e kryejnë atë (inspektorët shtetërorë dhe lokalë, inspektoratet e tjera të veçanta dhe të ngjashme), ndërsa kompetencat e tyre janë të elaboruara në nene të veçanta [për shembull, neni 60 i Ligjit për menaxhimin e rrjedhave shtesë të mbeburinave (*)].

³³ Neni 128, Ligji për ndërtim, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 130/09, 124/10, dhe 269/25.

³⁴ Neni 145, Ligji për ujërat, „Gazeta zyrtare e RM“, 6p. 6/2009, 161/2009, dhe 3/2025

³⁵ Neni 60, Ligji për veprimtari turistike, „Gazeta zyrtare e RMV“, 6p. 62/04, 89/08, dhe 156/25.

³⁶ Neni 58, Ligji për veprimtari turistike, „Gazeta zyrtare e RMV“, 6p. 62/04, 89/08, dhe 156/25.

Megjithatë, në disa ligje përdoret një qasje më e përgjithshme, ku nuk bëhet ndarje e drejtpërdrejtë dhe e qartë e kompetencave ndërmjet inspektorëve shtetërorë dhe atyre lokalë. Në vend të kësaj, ndarja del në mënyrë të tërthortë nga dispozitat kundërvajtëse, përkatësisht në dispozitat kundërvajtëse përcaktohet se cili inspektor është kompetent për të vepruar për secilën kundërvajtje. Për shembull, neni 59 paragrafi 1 i Ligjit për veprimtarinë hotelierike (2004) përcakton: „Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar i komunës dhe inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 67-a dhe 68 të këtij ligji, inspektori shtetëror i tregut, përkatësisht inspektori i autorizuar, është i detyruar të përgatit procesverbal (...)“ Më pas, në kapitullin VIII, me titull „Dispozitat kundërvajtëse“, neni 67-a paragrafi 2 sqaron: „Për kundërvajtjet nga paragrafi 1 i këtij neni ndaj personit fizik, inspektori i autorizuar i komunës, përkatësisht inspektori i autorizuar i Qytetit të Shkupit, do të zhvillojë procedurën e marrëveshjes përmes lëshimit të urdhërpagesës kundërvajtëse për pagesën e gjobës në shumën e përcaktuar, brenda afatit prej tetë ditësh nga dita e dorëzimit të urdhërpagesës kundërvajtëse.“ Kjo qasje është **më pak e shqyrtuar**, pasi kërkon interpretim dhe referim shtesë në më shumë nene, gjë që mund të çojë në paqartësi juridike ose në mangësi praktike.

Nga ligjet e analizuara të shpjeguara në fillim të analizës, si dhe të paraqitura në pasqyrën e sistematizuar, e vetmja situatë ligjore që nuk çon në një ndarje të qartë dhe eksplicite të kompetencave ndërmjet Qytetit të Shkupit dhe komunave në territorin e tij është çështja e transportit në komunikacionin rrugor, ku kryerja e mbikëqyrjes është paraqitur në mënyrë të përgjithshme. Më saktësisht, “inspektori i autorizuar i komunës ose inspektorët e autorizuar të Qytetit të Shkupit për komunikacionin rrugor kryejnë mbikëqyrje mbi:

- ◆ përmbushjen e kushteve për marrjen e licencës për transport komunal dhe auto-taksi të udhëtarëve,
- ◆ përmbushjen e kushteve të veçanta teknike dhe të shfrytëzimit të automjeteve me të cilat kryhet transporti komunal i udhëtarëve dhe transporti auto-taksi,
- ◆ transportin komunal linjëor të udhëtarëve,
- ◆ transportin auto-taksi të udhëtarëve,
- ◆ transportin e veçantë linjëor të udhëtarëve që kryhet në territorin e komunës ose në territorin e Qytetit të Shkupit,
- ◆ stacionet e taksive,

- ◆ përmbushjen e kushtit për posedimin e targës së verdhë të regjistrimit,
- ◆ posedimin e vërtetimit mjekësor të shoferit të taksisë,
- ◆ posedimin e ekstraktit nga licenca për automjetin që është objekt i kontrollit, dhe
- ◆ posedimin e certifikatës për shofer taksie.³⁷

Nga kjo dispozitë nuk rezulton ndarja materiale e kompetencave. Vetëm disa akte nënligjore i referohen kësaj ndarjeje, në përputhje me logjikën e natyrës së dimensionit territorial dhe vëllimit të shërbimit në fushën e transportit. Megjithatë, vetëm nga aspekti teorik, materia e kësaj fushë është e rregulluar në tërësi.

07

KRYERJA E MBIKËQYRJES INSPEKTUESE



Aspekt pozitiv i LMI (2025) është theksimi i dimensionit parandalues dhe jo represiv të mbikëqyrjes inspektuese, si dhe ligjshmëria në zbatimin e tij. Qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese është të veprohet në mënyrë parandaluese ose të ndërmerren masa për parandalimin apo eliminimin e pasojave ndaj të mirave, të drejtave ose interesave të mbrojtura, si dhe të shqiptohen masa inspektuese për eliminimin e parregullsive dhe mangësive të konstatuara.³⁸

Është theksuar e drejta e subjektit që i nënshtrohet mbikëqyrjes që, para së gjithash, t'i jepet mundësia për vërejtje, përkatësisht për eliminimin e aspekteve negative të gjendjes së konstatuar. Një zgjidhje e tillë është mbështetur edhe financiarisht (në rast se subjektit i shqiptohet vetëm vërejtje, ai nuk i bart shpenzimet e mbikëqyrjes).³⁹

Gjithashtu, është paraparë mundësia ligjore që, varësisht nga vëllimi dhe kompleksiteti i situatës, mbikëqyrjen inspektuese ta kryejnë edhe

³⁷ Neni 88, paragrafi 4, Ligji për transport në komunikacionit rrugor, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 68/04, 23/06, ... dhe 101/25.

³⁸ Neni 49, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

³⁹ Neni 52, paragrafi 2, alineja 9; neni 66, paragrafi 3; neni 68, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

më shumë inspektorë nga i njëjti ose nga inspektorate të ndryshme.⁴⁰ Kjo do të thotë se është përcaktuar një standard minimal për forcimin e mëtijshëm të cilësisë së mbikëqyrjes. Është lënë mundësia që, përmes rregullimit plotësues, të përcaktohen më saktë kushtet, rrethanat dhe mënyra e realizimit në të cilat mund të angazhohen më shumë inspektorë për të njëjtin rast.

Sa i përket veprimeve konkrete, përkatësisht të drejtave që kanë inspektorët gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, ato janë plotësisht në përputhje me funksionin që ata kryejnë në sistemin e administratës publike. Veçanërisht e rëndësishme është që inspektorateve u janë dhënë mundësi që, përveç kryerjes së çdo lloj kontrolli dhe shqyrtimi në punën e subjekteve nën mbikëqyrje, të kenë në dispozicion edhe masën e fundit – paraqitjen e kallëzimit penal kundër subjektit të mbikëqyrjes inspektuese pranë prokurorit publik kompetent.⁴¹

Modeli inspektues parandalues



Sa i përket përcaktimit të gjendjes faktike, përsëri në LMI janë parashikuar më shumë modalitete dhe kompetenca të inspektorateve për këtë qëllim - si mbikëqyrjeve të veçanta inspektuese, me detyrime të sakta të subjekteve që i nënshtrohen mbikëqyrjes për sigurimin e informacioneve, por edhe përmes mbikëqyrjes së përbashkët inspektuese⁴², në të cilën marrin pjesë më shumë inspektorate, njëkohësisht në interes të efikasitetit dhe për të shmangur ndryshimin e gjendjes faktike, ligji parashikon që edhe një inspektor nga një fushë tjetër mund ta konstatojë të njëjtën, nëse ndodhet në vendin e ngjarjes dhe bëhet fjalë për një gjendje të konstatuar në vend, pas së cilës ai është i detyruar të njoftojë me shkrim inspektoratin sektorial kompetent.⁴³ Përveç kësaj, mund të kërkohet edhe konslutim me persona të tjerë profesional administrativ ose të ndonjë profilit tjetër. Megjithatë, sipas zgjidhjes së re

⁴⁰ Neni 50, paragrafi 3, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25

⁴¹ Neni 52, paragrafi 2, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25

⁴² Neni 60, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

⁴³ Neni 52, paragrafi 5, Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta zyrtare e RMV“, nr. 135/25 dhe 269/25.

ligjore, iniciimi i mbikëqyrjes së përbashkët inspektuese është formalizuar më tej, përkatësisht i nënshtrohet hapave shtesë proceduralë, gjë që mund të ketë ndikim negativ në shpejtësinë e fillimit të saj.⁴⁴

Një kompleksitet i caktuar mund të konstatohet në pjesën ku, në përputhje me legjislacionin, inspektorët lokalë për mjedisin jetësor kanë përmbytje të gjera të mbikëqyrjes, duke kryer kështu mbikëqyrje si për mbrojtjen nga zhurma, ashtu edhe për gjendjen e ujërave në nivel lokal.

Çështjet komunale, si dhe çështjet që lidhen me furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të zeza urbane, në nivel lokal mbikëqyren nga inspektorët komunalë të autorizuar. Edhe pse, në parim, kompetencat lidhur me rrjetet e ujësjellësit dhe burimet ujore janë të përcaktuara dhe të ndara me ligj, megjithatë, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për sisteme natyrore dhe infrastrukturore të ndërlidhura, ekziston mundësia e një mbivendosjeje të mundshme të kompetencave e cila nuk rezulton nga kuadri ligjor, por nga vetë natyra e objektit të mbikëqyrjes. Çdo paqartësi lidhur me konfliktin e mundshëm pozitiv ose negativ të kompetencave mund të zgjidhet përmes propozimit të paraqitur më parë, si dhe përmes mundësisë ligjore që lidhet me rolin e Kolegjiumit të paraparë me LMI.

08



MBIKËQYRJE MBI LIGJSHMËRINË NË PUNËN E SHËRBIMEVE INSPEKTUESE LOKALE

Mbikëqyrjen mbi zbatimin e Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit (2025), në fund të fundit, e kryen Ministria e Administratës Publike, ndërsa mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve që nxjerrin njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe zbatimin e tyre, në fund të fundit, e kryen Ministria e Vetëqeverisjes Lokale.

Në shumicën e ligjeve sektoriale, mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së komunave në një fushë konkrete (ndërtimtari, veprimtari komunale, mbrojtje e mjedisit jetësor etj.) është rregulluar në mënyrë të

⁴⁴ Sipas ligjit të mëparshëm, kryetari i Këshillit Inspektues në mënyrë të drejtpërdrejtë nxirrte urdhër për zbatimin e mbikëqyrjes së përbashkët të jashtëzakonshme inspektuese, ndërsa zgjidhja e re ligjore parasheh fillimisht paraqitjen e një propozimi, thirrjen e mbledhjes së Kolegjiumit dhe miratimin e një vendimi të veçantë për kryerjen e mbikëqyrjes.

përgjithshme dhe deklarative. Ligjet përcaktojnë organin kompetent (ministri në përkatësi), por pa e përcaktuar në mënyrë të detajuar procedurën, instrumentet, organet apo afatet për kryerjen e mbikëqyrjes [për shembull, neni 147 i Ligjit për ndërtim (2009)]. Në të kundërt, në fushën e mjedisit jetësor [nenet 42 dhe 43 të Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit në mjedisin jetësor (2022)], i njëjti lloj mbikëqyrjeje – mbi ligjshmërinë e punës së shërbimeve inspektuese komunale – është rregulluar në mënyrë dukshëm më të detajuar. Ligji parasheh që ministri të themelojë Komisionin për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të ligjit në nivel lokal, i cili kryen kontrollin e punës së shërbimeve inspektuese lokale. Në kuadër të kompetencave të tij, Komisioni verifikon nëse komunat kanë siguruar inspektor për mjedisin jetësor ose administratë të përbashkët për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, nëse i ndjekin dhe i zbatojnë dokumentet planifikuese të përcaktuara me ligj, nëse mbikëqyrja inspektuese realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe nëse të dhënat dorëzohen dhe regjistrohen në bazat e parashikuara të të dhënave. Pas kryerjes së mbikëqyrjes, Komisioni përgatit raport, në të cilin mund të konstatojë tejkalim të kompetencave, të identifikojë mangësi materiale dhe procedurale, të japë udhëzime, masa dhe rekomandime për eliminimin e tyre, si dhe të përcaktojë afate për veprim.

Në mënyrë shtesë, ligji parasheh edhe një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të masave të përcaktuara. Nëse komuna nuk i eliminon mangësitë e konstatuara, parashihen hapa të mëtejshëm që mund të çojnë në ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara nga ana e Inspektoratit Shtetëror për Mjedisin Jetësor, në emër dhe në llogari të komunës, madje edhe në fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj kryetarit të komunës. Në këtë mënyrë, mbikëqyrja merr një formë më të formalizuar, të strukturuar dhe të parashikueshme.

Në pjesën më të madhe të ligjeve sektoriale, mbikëqyrja e ligjshmërisë së punës së komunave në një fushë të caktuar (ndërtimtari, veprimtari komunale, mbrojtje e mjedisit jetësor etj.) është rregulluar në mënyrë të përgjithshme dhe deklarative.

Me fjalë të tjera, përderisa në Ligjin për ndërtim dhe në shumicën e dispozitave të tjera që rregullojnë kompetencat e NJVL-ve, mbikëqyrja e ligjshmërisë funksionon si autorizim i përgjithshëm pa një kornizë të detajuar procedurale, në Ligjin për mbikëqyrje të inspektoratit në mjedisin jetësor (2022), ajo është institucionalizuar dhe operacional-

izuar përmes një organi të veçantë, aktiviteteve të përcaktuara qartë të mbikëqyrjes, raporteve të detyrueshme, masave për eliminimin e mangësive dhe mekanizmave për monitorimin e zbatimit të tyre. Kjo zgjidhje është e veçantë në kuadër të legjislacionit të analizuar dhe tregon synimin e ligjvënësit për të siguruar një nivel më të lartë të sistematicitetit, kontrollit dhe transparencës në ushtrimin e mbikëqyrjes në nivel lokal (me gjasë edhe për shkak se ky ligj është harmonizuar me aktet përkatëse evropiane në këtë fushë).

Prandaj, do të ishte e arsyeshme të shqyrtohet mundësia e *ndërmarrjes së një zgjidhjeje të tillë ligjore nga fusha e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe integritetit të saj edhe në fusha të tjera në kompetencë të komunave*. Në këtë mënyrë do të vendosej një model i unifikuar dhe më i zhvilluar i kontrollit mbi zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese

Një formë e veçantë e kontrollit të shtetit mbi punën e inspektorëve lokalë është situata kur vetëqeverisja lokale nuk ka siguruar fare shërbim inspektues ose kur ai ekziston vetëm formalisht, por nuk kryhet ose kryhet në mënyrë të papërshtatshme. Në një rast të tillë, inspektori shtetëror kompetent i kryen detyrat nga fusha e mbikëqyrjes inspektuese lokale në emër dhe për llogari të komunës, për një periudhë jo më të gjatë se një vit. Kjo formë e kontrollit parashihet në nenet 144 dhe 145 të Ligjit për ndërtim (2009), si dhe pothuajse në të gjitha ligjet e tjera që rregullojnë fushat në kompetencë të komunave, në pjesën që ka të bëjë me mbikëqyrjen inspektuese. Në nenin 144 rregullohet situata e parë – kur komuna nuk ka inspektor të autorizuar. Në një rast të tillë, inspektori shtetëror i ndërtimit, pas konstatimit të gjendjes faktike, fillon procedurën dhe, me autorizim të ministrit, përkohësisht e merr përsipër këtë funksion. Kjo zgjat deri në momentin kur komuna të krijojë kapacitetin e vet inspektues, por me kufizim kohor prej maksimum një viti. Neni 145 përfshin situatën e dytë – kur inspektori komunal ekziston, por nuk i ushtron kompetencat e tij ligjore. Në këtë rast, mekanizmi është gradual: fillimisht jepet një udhëzim, ndërsa nëse nuk ndërmerret veprim, zhvillohet procedurë formale pas së cilës inspektori shtetëror i merr përsipër detyrat konkrete. E përbashkëta e këtyre mekanizmave është se vendosin një ndërhyrje zëvendësuese të shtetit – ato paraqesin një formë më intensive të mbikëqyrjes, ku shteti nuk kufizohet vetëm në kontrollin e ligjshmërisë, por ndërhyr drejtpërdrejt dhe e ushtron funksionin e organit lokal. Në të njëjtën kohë, duke qenë se shpenzimet për një ndërhyrje të tillë bien në barë të komunës, vendoset edhe një element i qartë i përgjegjësisë institucionale.

Megjithatë, mbetet e hapur çështja se çfarë do të ndodhte nëse edhe pas një viti nuk do të sigurohet një shërbim funksional sektorial lokal inspektues? Ndër të tjera, kjo çështje zgjidhet përmes njërës prej rekomandimeve – **të përcaktohet me ligj numri minimal i shërbimeve të**

detyrueshme inspektuese në çdo komunë, në fushat më kritike që janë me rëndësi thelbësore për përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve. Detyrimi për financimin dhe sigurimin e kuadrit të tyre duhet të jetë, në radhë të parë, përgjegjësi e shtetit.

Mbetet e hapur pyetja se çfarë do të ndodhte nëse edhe pas atij një viti nuk sigurohet funksionimi i një shërbimi funksional inspektues sektorial në nivel lokal?

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



01

Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe vëllimin e kësaj materie, përfundimi i përgjithshëm është se kuadri ligjor material në fuqi siguron standarde të caktuara dhe qartësi të rregullave për funksionimin e inspektorateve shtetërore dhe lokale. Disa aspekte të tij mund të përmirësohen dhe të ndryshohen në përputhje me rrethanat dhe nevojat në administratën publike dhe në sektorët përkatës, megjithatë, në thelb, sistemi është i strukturuar dhe i vendosur. Sidoqoftë, funksionaliteti i tij real mund të vlerësohet vetëm përmes analizës së zbatimit të zgjidhjeve ligjore që lidhen me mbikëqyrjen inspektuese në praktikë, si dhe përmes analizës së dispozitave përkatëse procedurale.

02

Përmes punës së Kolegjiumit të drejtorëve të inspektorateve shtetërore, ekziston nevoja që të përcaktohen më qartë dhe të operacionalizohen mënyrat përmes të cilave do të realizohet një ndërveprim më i drejtpërdrejtë dhe një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet inspektorateve shtetërore dhe lokale, qoftë përmes inspektimeve të përbashkëta të rregullta ose të jashtëzakonshme, shkëmbimit të informatave, takimeve të rregullta për monitorimin e gjendjeve në fusha të caktuara, krijimit të një baze të përbashkët të të dhënave sipas fushave, standardizimit të punës dhe të ngjashme.

03

Në mënyrë normative të rregullohet mundësia që Kolegjiumi të japë mendim këshillëdhënës për zgjidhjen e dilemave juridike lidhur me konfliktin pozitiv dhe negativ të kompetencave ndërmjet inspektorateve lokale dhe shtetërore.

04

Është e dobishme që në mënyrë normative të përcaktohet numri dhe lloji minimal i inspektimeve që duhet të ekzistojnë në kuadër të NJVL-ve, me qëllim të sigurimit të një standardi minimal për cilësinë e jetës në çdo NJVL. Numri minimal i shërbimeve inspektuese duhet të përf-

shijë fushat e ndërtimtarisë, veprimtarive komunale, arsimit, mjedisit jetësor, transportit, mbrojtjes dhe shpëtimit. Përveç kësaj, në varësi të karakteristikave të NJVL-së, sipas nevojës mund të themelohen shërbime inspektuese edhe në fushat e turizmit, bujqësisë etj. Detyrimi për financimin dhe pajisjen me kuadër të këtyre shërbimeve duhet të jetë, në radhë të parë, përgjegjësi e shtetit.

05

Me qëllim të racionalizimit të burimeve, përmes mundësive që ofrohen nga bashkëpunimi ndërkomunal, të lidhen marrëveshje ndërkomunale ndërmjet komunave fqinje më të afërta për themelimin e shërbimeve të përbashkëta lokale minimale të përcaktuara të inspektimit, kompetencat e të cilave do të përfshijnë dhe mbulojnë këto NJVL.

06

Të shqyrtohet mundësia për krijimin e një sistemi unik të mbikëqyrjes inspektuese, i cili do të mundësojë një veprim të koordinuar të inspektorëve shtetërorë dhe lokalë. Në sistem do të futen programet vjetore, planet mujore dhe raportet për mbikëqyrjet e kryera, me qëllim që të monitorohet qartë se cilat subjekte dhe fusha janë përfshirë në mbikëqyrjen inspektuese, nëse ekziston mbivendosje e kompetencave dhe kontrolleve ndërmjet shërbimeve të ndryshme inspektuese, si dhe nëse fusha ose subjekte të caktuara mbeten pjesërisht ose tërësisht të pambuluara me mbikëqyrje.

07

Raporti vjetor dhe planet e punës duhet të digjitalizohen dhe të ndërliohen në një sistem që posedon metodologji të unifikuar për vlerësimin e rrezikut. Në këtë mënyrë, gjatë futjes së të dhënave do të mund të identifikohet se ku gjenerohet rreziku në fushën e përcaktuar dhe të ndërhyhet në kohë.

08

Të parashihet mundësia për një mekanizëm të standardizuar kontrolli gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese lokale në të gjitha fushat e kompetencës së NJVL-ve, sipas shembullit të Komisionit për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit në mjedisin jetësor (2022), në nivel lokal.

09

Të rishqyrtohet heqja e sistemit të licencimit të inspektorëve dhe të analizohet nevoja për rikthimin e tij, me çka do të mundësohej diferencimi sipas shkallës së kompleksitetit dhe përgjegjësisë së punëve inspektuese. Zgjidhja aktuale, e cila parasheh vetëm vërtetim për dhënien e provimit për inspektor, nuk mundëson vlerësimin përkatës të shkallëve të ndryshme të kompleksitetit të detyrave të punës që kryejnë inspektorët.

10

Të unifikohet statusi ligjor i inspektorëve, duke pasur parasysh se aktualisht ata i nënshtrohen njëkohësisht tre ligjeve (Ligjit për nëpunësit administrativë, Ligjit për marrëdhëniet e punës dhe Ligjit për mbikëqyrje të inspektoratit) – në njërin ligj përcaktohen si nëpunës të veçantë administrativë, ndërsa në tjetrin si nëpunës administrativë, me ç'rast në praktikë krijohet pasiguri juridike kur bëhet fjalë për çështje nga fusha e marrëdhënieve të punës. Të shqyrtohet mundësia për miratimin e një ligji lex specialisv për nëpunësit inspektues, me të cilin në mënyrë më konkrete do të rregulloheshin kushtet dhe procedura për punësimin e inspektorëve, sistemi i licencimit, rangimi sipas titujve, zhvillimi profesional, si dhe çështje të tjera që lidhen me statusin dhe karrierën e nëpunësve të inspektoratit.

11

Të detajohen me kujdes mekanizmat e standardizuar për transferimin e institucionalizuar të njohurive dhe trajnimeve për inspektorët lokalë nga ana e Akademisë për Aftësim Profesional dhe Trajnim të Nëpunësve Administrativë.



REFERENCA

Ligji për nëpunësit administrativë, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 144/25, 252/25 dhe 266/25.

Ligji për ujërat, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 6/2009, 161/2009, 83/2010, 51/2011, 44/2012, 23/2013, 163/2013, 180/2014, 146/2015 dhe 52/2016, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 151/2021, 99/2022 dhe 3/2025.

Ligji për ndërtim, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 130/09, 124/10, 18/11, 36/11, 54/11, 13/12, 144/12, 25/13, 79/13, 137/13, 163/13, 27/14, 28/14, 42/14, 115/14, 149/14, 187/14, 44/15, 129/15, 217/15, 226/15, 30/16, 34/16, 39/16, 71/16, 132/16, 35/18, 64/18 dhe 168/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 244/19, 18/20, 279/20, 227/22, 111/23, 224/24, 224/24, 255/24, 3/25, 17/25, 87/25, 101/25, 250/25, 269/25 dhe 51/26, si dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 18/11, 49/11, 103/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 15/2020, 6/21 dhe 115/23.

Ligji për tokën ndërtimore, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 1/16, 142/16 dhe 190/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 275/19, 101/21, 153/22, 61/24, 224/24, 233/24 dhe 87/25.

Ligji për Qytetin e Shkupit, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 55/2004 dhe 158/2011.

Ligji për varrezat dhe shërbimet funerale, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 86/08, 156/10, 53/11, 163/13, 152/15 dhe 31/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 255/24 dhe 101/25.

Ligji për tatimet mbi pronën, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 61/04, 92/07, 102/08, 35/11, 53/11, 84/12, 188/13, 154/15, 192/15 dhe 23/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 151/21.

Ligji për banim, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 99/2009, 57/10, 36/11, 98/11, 14/12, 55/13, 163/13, 42/14, 146/15, 31/16 dhe 64/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 302/20, 150/22, 224/24 dhe 160/25.

Ligji për mjedisin jetësor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16.

Ligji për ndalimin dhe parandalimin e kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 199/14 dhe 147/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 18/20 dhe 86/25.

Ligji për zejtarinë, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 215/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 215/21.

Ligji për mbrojtjen e fëmijëve, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18 dhe 198/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 104/19, 146/19, 275/19, 311/20,

294/21, 150/22, 236/22, 17/25 dhe 132/25.

Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 79/07, 124/10, 4/11, 163/13 dhe 146/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 151/21 dhe 3/25.

Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 102/19, 272/24 dhe 22/25 – i shfuqizuar

Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 135/25 dhe 269/25.

Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit në mjedisin jetësor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 99/22 dhe 3/25.

Ligji për pastërtinë publike, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 111/08, 64/09, 88/10, 114/10, 23/11, 53/11, 80/12, 163/13, 44/15, 147/15 dhe 31/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 122/21, 255/24 dhe 101/25.

Ligji për rrugët publike, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 84/08, 52/09, 114/09, 160/09, 123/10, 23/1, 53/1, 44/12, 68/12, 63/13, 187/13, 39/14, 42/14, 166/14, 44/15, 116/16, 150/15, 31/6, 71/116 dhe 163/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 174/21, 253/23, 224/24, 135/25 dhe 269/25.

Ligji për cilësinë e ajrit ambiental, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 67/04, 92/07, 35/10, 47/11, 59/12, 163/13, 10/15 dhe 146/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 151/21 dhe 3/25.

Ligji për veprimtaritë komunale, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 95/2012, 163/31, 42/14, 44/5, 47/5, 147/15, 31/16 dhe 64/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 302/20, 255/24, 3/25 dhe 17/25.

Ligji për vetëqeverisjen lokale, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 5/02, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 202/24.

Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 79/09, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 241/24.

Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 161/2019.

Ligji për përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 66/04, 55/07, 145/10, 136/11, 163/13 dhe 147/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 224/24.

Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr.

124/15 dhe 65/18.

Ligji për arsimin fillor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 161/19, 229/20, 3/25, 74/25, 250/25 dhe 250/25.

Ligji për veprimin sipas parashtresave dhe propozimeve, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 82/08, 13/13, 156/15 dhe 193/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 208/24.

Ligji për trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 23/11, 54/11, 155/12, 53/13, 72/13, 44/14, 115/14, 19/15, 124/15 dhe 129/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 21/15, 1/16, 190/16 deri në 174/21.

Ligji për transportin në komunikacionin rrugor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 68/04, 23/06, 22/07, 114/09, 50/10, 83/10, 140/10, 152/10, 17/11, 53/11, 6/12, 23/13, 120/13, 163/13, 187/13, 4/14, 112/14, 166/14, 33/15, 97/15, 124/15, 193/15, 37/16, 71/16, 64/18, 140/18 dhe 163/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 275/19, 67/22, 170/24, 3/25, 17/25 dhe 101/25.

Ligji për kundërvajtjet, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 96/19, 253/23, 13/26 dhe 26/26.

Ligji për inspektimin arsimor, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 137/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 64/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 3/25 dhe 74/25.

Ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 215/21 dhe 73/24.

Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 101/19.

Ligji për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të zeza urbane, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 68/04, 28/06, 16/07, 103/08, 17/11, 54/11, 163/13, 10/15, 147/15 dhe 31/16, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 21/21, si dhe Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 16/07 dhe 95/19.

Ligji për aftësimin profesional dhe trajnimin e nëpunësve administrativë, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 144/25.

Ligji për arsimin e mesëm, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25.

Ligji për taksën e qëndrimit të përkohshëm, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 19/96, 26/02, 51/03, 88/08, 17/11 dhe 192/15, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 31/20 dhe 16/25.

Ligji për veprimtarinë turistike, „Gazeta Zyrtare e Re-

publikës së Maqedonisë“, nr. 62/04, 89/08, 12/09, 17/11, 47/11, 53/11, 123/12, 164/13, 27/14, 116/15, 192/15 dhe 53/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 31/20, 16/25 dhe 156/25.

Ligji për veprimtarinë hoteliere, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 62/04, 89/08, 115/10, 53/11, 141/12, 164/13, 187/13, 166/14, 199/14, 129/15, 192/15, 39/16, 53/16 dhe 71/16, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 31/20 dhe 16/25.

Ligji për menaxhimin e baterive dhe akumulatorëve, si dhe mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 176/21 dhe 3/25.

Ligji për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 216/21 dhe 195/22.

Ligji për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike, si dhe mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 176/21 dhe 73/24.

Ligji për menaxhimin e mbeturinave, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 216/21 dhe 3/25.

Ligji për menaxhimin e ambalazhit dhe mbeturinave nga ambalazhi, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 215/21 dhe 3/25.

Ligji për planifikimin urbanistik, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 32/20, 111/23, 73/24, 171/24, 224/24, 40/25, 101/25 dhe 127/25.

Ligji për gjelbërimin urban, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 11/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 42/20 dhe 224/24.

Ligji për standardin e nxënësve, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 52/05, 117/08, 17/11, 135/11, 15/13, 41/14, 146/15, 30/16, 64/18 dhe 20/19, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 248/20, 302/20 dhe 235/24.

Kodi Penal, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 37/96, 80/99, 4/02, 43/03, 19/04, 81/05, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 41/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18, dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“, nr. 36/23, 188/23, 16/26 dhe 17/26.

Ministria e administratës publike, Njoftim 09.03.2026, <https://mja.gov.mk/mk-MK/odnosi-so-javnost/najavi/skratena-programa-za-polaganje-na-ispitot-za-inspektor>.

Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, nr. 53/91, dhe Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut (nga 12.01.2019); si dhe amendamentet I–XXXVI.



ANEKS

LISTA E LIGJEVE QË PËRMBAJNË DIS- POZITA TË DREJTPËRDREJTA PËR MBIKËQYRJEN INSPEKTUESE LOKALE

**Fusha e
kompetencës
së komunës**

**Ligjet
përkatëse**

01

Ndërtimtaria

- Ligji për ndërtim („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 130/09, 124/10, 18, dhe 51/26)*
- Ligji për ndalimin dhe parandalimin e kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 199/14, 147/15, dhe 86/25)*

02

Planifikimi urbanistik
(urban dhe rural)

- Ligji për ndërtim („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 130/09, 124/10, 18, dhe 51/26)
- Ligji për gjelbërimin urban („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 11/18, 42/20, dhe 224/24)
- Ligji për përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 66/04, 55/07, dhe 224/24)
- Ligji për ndalimin dhe parandalimin e kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 199/14, 147/15, dhe 86/25)*

03

Mbrojtja e mjedisit
jetësor dhe e natyrës

- Ligji për mjedisin jetësor („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 53/05, 81/05, dhe 39/16)
- Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit në mjedisin jetësor („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 99/22, dhe 3/25)
- Ligji për cilësinë e ajrit ambiental („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 67/04, 92/07, dhe 3/25)
- Ligji për menaxhimin e mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 216/21, dhe 3/25)*
- Ligji për menaxhimin e ambalazhit dhe mbeturinave nga ambalazhi („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 215/21, dhe 3/25)*
- Ligji për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 216/21, dhe 195/22)*
- Ligji për menaxhimin e baterive dhe akumulatorëve dhe mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 176/21, dhe 3/25)*
- Ligji për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 176/21, dhe 73/24)*
- Ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 215/21, dhe 73/24)*
- Ligji për gjelbërimin urban („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 11/18, 42/20, dhe 224/24)*
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma në mjedisin jetësor („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 79/07, 124/10, dhe 3/25)

04

Zhvillimi ekonomik lokal

- Ligji për veprimtarinë hoteliere („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 62/04, 89/08, dhe 16/25)
- Ligji për veprimtarinë turistike („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 62/04, 89/08, dhe 156/25)
- Ligji për taksën e qëndrimit të përkohshëm („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 19/96, 26/02, dhe 16/25)
- Ligji për zejtarinë („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 215/15, dhe 215/21)
- Ligji për tatimet mbi pronën („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 61/04, 92/07, dhe 151/21)
- Ligji për ndalimin dhe parandalimin e kryerjes së veprimtarisë së paregjistruar („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 199/14, 147/15, dhe 86/25)

05

Veprimtaritë komunale

- Ligji për veprimtaritë komunale („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 95/2012, 163/13, dhe 17/25)
- Ligji për furnizimin me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të zeza urbane („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 68/2004, 28/06, dhe 21/21)
- Ligji për ujërat („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 6/2009, 161/2009, dhe 3/2025)
- Ligji për transportin në komunikacionin rrugor („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 68/04, 23/06, dhe 101/25)
- Ligji për rrugët publike („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 84/08, 52/09, dhe 269/25)
- Ligji për pastërtinë publike („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 111/08, 64/09, dhe 101/25)
- Ligji për varrezat dhe shërbimet funerale („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 86/08, 156/10, dhe 101/25)
- Ligji për gjelbërimin urban („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 11/18, 42/20, dhe 224/24)
- Ligji për përcaktimin e emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve të tjera infrastrukturore („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 66/04, 55/07, dhe 224/24)
- Ligji për menaxhimin e mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 216/21, dhe 3/25)
- Ligji për menaxhimin e ambalazhit dhe mbeturinave nga ambalazhi („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 215/21, dhe 3/25)
- Ligji për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 216/21, dhe 195/22)
- Ligji për menaxhimin e baterive dhe akumulatorëve dhe mbeturinave nga bateritë dhe akumulatorët („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 176/21, dhe 3/25)
- Ligji për menaxhimin e pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe mbeturinave nga pajisjet elektrike dhe elektronike („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 176/21, dhe 73/24)
- Ligji për përgjegjësinë e zgjeruar të prodhuesit për menaxhimin e rrjedhave të veçanta të mbeturinave („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 215/21, dhe 73/24)

06

Mbrojtja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve

- Ligji për mbrojtjen e fëmijëve („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 23/13, 12/14, dhe 132/25)
- Ligji për banim („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 99/2009, 57/10, dhe 160/25)*

07**Banimi**

- Ligji për banim („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 99/2009, 57/10, dhe 160/25)

08**Arsimi**

- Ligji për arsimin fillor („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 161/19, 229/20, dhe 250/25)
- Ligji për arsimin e mesëm („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 44/95, 24/96, dhe 250/25)
- Ligji për standardin e nxënësve („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 52/05, 117/08, dhe 235/24)
- Ligji për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesionalë në shkollat fillore dhe të mesme („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 161/2019)
- Ligji për inspektimin arsimor („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 52/05, 81/08, dhe 74/25)

09**Ligje të përgjithshme (horizontale) të zbatueshme në të gjitha fushat**

- Ligji për vetëqeverisjen lokale („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 5/02, dhe 202/24)
- Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 102/19, 272/24, dhe 22/25)
- Ligji për mbikëqyrje të inspektoratit („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 135/25, dhe 269/25)
- Ligji për nëpunësit administrativë („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 144/25, 252/25, dhe 266/25)
- Ligji për aftësimin profesional dhe trajnimin e nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 144/25)
- Ligji për bashkëpunimin ndërkomunal („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 79/09, dhe 241/24)
- Ligji për veprimin sipas parashtrësve dhe propozimeve („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 82/08, 13/13, dhe 208/24)
- Ligji për kundërvajtjet („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 96/19, 253/23, dhe 26/26)
- Ligji për procedurën e përgjithshme administrative („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 124/15)
- Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik („Gazeta Zyrtare e RMV“, nr. 101/19)
- Kodi Penal („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 37/96, 80/99, dhe 17/26)
- Ligji për Qytetin e Shkupit („Gazeta Zyrtare e RM“, nr. 55/2004, dhe 158/2011)

Shënim: Disa ligje (të shënuara me yll – *), janë përfshirë në më shumë se një fushë të kompetencës, për shkak se rregullojnë çështje me karakter ndërsektorial, të cilat lidhen me ushtrimin e më shumë kompetencave lokale.

Instituti
për kërkime sociologjike
dhe politiko-juridike

Universiteti
„Shën Kirili dhe Metodi“
në Shkup